

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shpërndanin lëndë narkotike në Laç, përfundojnë në pranga lushnjari dhe tironsi! Sekuestrohen 80 doza gati për shitje
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/shperndanin-lende-e-ne-lac-perfundojne-ne-pranga-lushnjar-i-dh-i401617
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 12:59:53 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 12:58:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	bd813867330d719cbdab4852bab8cabe74bfbe935207b322cb5121ed8694267e
TEKSTI	b3edfa682ea18c6930d0767a29b7e28bf9b557b21195eef706556bd628c6176b
PAMJA	6c593b8851a67149186316ab3de447a7142c67207e6da60306cb0507e25399ee

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	9168ead99e6add4186a694d15958673f5562720813dec39358d0296a40194acf
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	aea7d85c4e1ffedb330a4f0c595bceb62319ead8019dd1bf570799cb9f2d4d85
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/9168ead99e6add4186a694d15958673f5562720813dec39358d0296a40194acf>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

[Kreu](#)
[Politikë](#)
[Aktualitet](#)
[Ekonomi](#)
[Kulturë & Art](#)
[Rajon](#)
[Sport](#)
[Bota](#)
[Showbiz](#)
[SocialBomb](#)


Çështjet kryesore

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

Aktualitet

19 Shtator 2026, 14:58

Shpërndanin lëndë narkotike në Laç, përfundojnë në pranga lushnjari dhe tironsi! Sekuestrohen 80 doza gati për shitje



Shkruar nga Newsbomb



LEZHË

Droga e gjetur në automjet

Policia e Lezhës ka arrestuar në flagrancë dy persona, të cilët dyshohet se shpërndanin lëndë narkotike në qytetin e Laçit. Sipas njoftimit të policisë, në pranga kanë rënë shtetasit G. M., 28 vjeç, banues në Lushnjë, dhe S. K., 19 vjeç, banues në Tiranë.

Të dy të rinjtë dyshohet se ushtronin veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së lëndëve narkotike në qytetin e Laçit. Ata janë lokalizuar dhe ndaluar në lagjen nr. 6, Laç, ndërsa gjatë kontrollit të automjetit me të cilin udhëtonin, policia ka gjetur dhe sekuestruar një sasi lëndë narkotike të dyshuar si kokainë, të ndarë në 80 doza të gatshme për shitje.

Nga veprimet hetimore dyshohet se dy të arrestuarit siguronin lëndën narkotike dhe më pas e ndanin në doza, me qëllim shpërndarjen e saj në qytetin e Laçit. Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan lëndë narkotike, një automjet dhe katër aparate celulare.

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



OpEd

Nevoja për kthjelltësi strategjike në kohë zhgënjimi: Lufta jonë është kundër padrejtësisë, jo kundër Perëndimit



Sporti

E BUJSHME/ U la jashtë listës së Kombëtares, "shpërthen" sulmuesi: Po ri urtë, më mirë të mos flas më...

Zbulu më shumë artikuj >

Njoftimi i Policisë:

Lezhë/Finalizohet operacioni policor i koduar "Destinacioni".

Goditet një rast i shpërndarjes së lëndëve narkotike në doza.

Shpërndanin kokainë në qytetin e Laçit, vihen në pranga 2 shtetas.

Sekuestrohet një sasi lënde narkotike kokainë, e ndarë në dhjetëra doza, gati për shitje, 1 automjet dhe 4 aparate celulare.

Shërbimet e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve, në bashkëpunim me shërbimet e Komisarariatit të Policisë Kurbin, në vijim të punës për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve, bazuar në informacionet e siguruar në rrugë operative, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar "Destinacioni".

Si rezultat i këtij operacioni, u arrestuan në flagrancë shtetasit:

G. M., 28 vjeç, banues në Lushnjë dhe S. K., 19 vjeç, banues në Tiranë.

Këta shtetas dyshohet se ushtronin veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së lëndëve narkotike në qytetin e Laçit.

Shërbimet e Policisë kanë lokalizuar dhe ndaluar këta shtetas në lagjen nr. 6, Laç, ku, gjatë kontrollit të automjetit me të cilin udhëtonin, iu gjetën dhe sekuestruan një sasi lënde narkotike kokainë, e ndarë në 80 doza, të gatshme për shitje.

Nga veprimet hetimore dyshohet se këta shtetas siguronin lëndën narkotike kokainë dhe më pas e ndanin në doza, me qëllim shpërndarjen e saj në qytetin e Laçit.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan lënda narkotike, 1 automjet dhe 4 aparate celulare.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për veprime të mëtejshme

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Shtunë 14:45

Qëlloi për vdekje bashkëshorten me thikë "në zemër" të Tiranës. DEL foto e 68-


Në zemër të Tiranës, DELIOTO E 60 vjeçarit Hysni Patushi



Aktualitet

"Kryeqyteti nuk mund t'ua japë lirinë, por mund t'i nderojë", reagon Veliaj për vendimin e Hagës: Ish-krerët e UÇK-së të shpallen qytetarë nderi të Tiranës

E Shtunë 14:23



Aktualitet

Rama vizitë disaditore në SHBA, zbardhet agjenda: Kryeministri merr pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së

E Shtunë 13:57



E Shtunë 13:39

Aksident i rëndë në aksin Fier-Patos, automjeti përplas motorin, plagoset një person



Aktualitet

Vrau bashkëshorten me thikë, arrestohet në Kamëz pas dy orësh Hysni Patushi

E Shtunë 13:06



Aktualitet

Shqipëria do të nënshkruajë Marrëveshjet Artemis, Ambasada Amerikane: Hap gjigant për të pasur akses në eksplorimin civil të Hënës dhe Marsit

E Shtunë 12:54





E Shtunë 12:53

Vrau bashkëshorten në sy të nipit të mitur, Policia jep detaje: 68-vjeçari arratiset nga ngjarja (EMRAT)



Aktualitet

Polemikat për manekinin e Çerçiz Topullit, jep dorëheqjen kreu i Agjencisë së Trashëgimisë Kulturore në Gjirokastrë: Përgjegjësia është e imja

E Shtunë 12:16



Aktualitet

Tronditet Tirana! Burri vret me thikë gruan te Zogu i Zi

E Shtunë 12:09



E Shtunë 12:01

Greqia "kopsit" skenarët për Alket Rizain, tani që u arratis e akuzon edhe për një vrasje brenda në burg



Aktualitet

Të shtëna me armë zjarri në një kantier ndërtimi në Tiranë, plagoset menaxheri i firmës

E Shtunë 11:53



Aktualitet

Reshje shiu me shtrëngata dhe rrezik i moderuar për zjarre, Instituti i Gjeoshkencave thirrje për kujdes në disa qarqe

E Shtunë 11:26





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.